



Tiranë, 29 Qershor 2022

## **Deklaratë e Përbashkët Publike e Organizatave të Shoqërisë Civile “Mbi Samitin BE-Ballkani Perëndimor, Qershor 2022”**

Samiti i rradhës BE-Ballkani Perëndimor vjen në një moment kyç të zhvillimeve gjeopolitike dhe strategjike, të cilat nuk përfshijnë vetëm rajonin, por Evropën dhe më gjerë. Nga njëra anë qëndron nevoja për komunikim të vazhdueshëm dhe unifikim qëndrimesh mes BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor për situatën famëkeqe në Ukrainë dhe Evropën Lindore dhe nga ana tjetër domosdoshmëria për të çuar përpara procesin e integritit të vendeve të Ballkanit Perëndimor ku çështja e mbajtjes së Konferencës së Parë Ndërqeveritare (KPN) midis BE-së dhe Shqipërisë është kthyer tashmë në refrenin kryesor të çdo komunikimi publik sa i përket këtij procesi.<sup>1</sup>

Organizatave të Shoqërisë Civile si shprehëse të vullnetit të disa qytetarëve<sup>2</sup> mbështesin fuqimisht dhe kontribuojnë në vazhdimësi për arritjen e këtij objekti. Roli dhe rëndësia që ka përfshija e shoqërisë civile apo grupeve të tjera të interesit në procesin politik dhe teknik të negociatave është shprehur edhe në metodologjinë e re të zgjerimit që do të përdoret si udhërrëfyes për negociatat midis BE-së dhe Shqipërisë.

Ashtu siç është theksuar në të gjithë kuadrin politik apo teknik të institucioneve të BE-së, qëllimi përfundimtar i të gjithë këtyre përpjekjeve është anëtarësimi i Shqipërisë dhe gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Ky objektivi nuk duhet parë vetëm në rrafshin formal, por edhe substancialisht, ku mbi të gjitha përfshihet transformimi i shoqërisë shqiptare në një shoqëri ku mbizotërojnë vlerat dhe principet evropiane, parimet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, dhe ku niveli i mirëqënies sociale dhe ekonomike arrin standardet e kërkuara nga qytetarët.

Që nga momenti që ky qëllim final përmendet, është e lehtësisht e perceptueshme se pavarësisht reformave të ndërmarra në vendin tonë, është e kuptueshme të mendohet se Shqipëria është ende larg arritjes së tij. Me synim arritjen e këtij qëllimi, vlerësojmë se do të duhet të dimensionohet si një objektivi kombëtar, dhe jo vetëm shtetëror apo i grupeve të caktuara shoqërore.

Ndaj, disa prej organizatave të shoqërisë civile të interesuara për avancimin e procesit të integritit evropian adresojnë këtë thirrje publike drejtuar:

<sup>1</sup> Objektivat e Samitit të radhës, të realizuar më datë 23-24.06.2022, synonin: (i) eksplorimin e mënyrave inovatore për të çuar përpara procesin e integritit të vendeve të BP; (ii) ndërmarrjen e reformave nxitëse, si dhe (iii) duke bërë përparim në integritimin gradual midis BE-së dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor.

<https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/international-summit/2022/06/23/>

<sup>2</sup> 96.69% e të intervistuarve mbështesin anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian  
<http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2022/04/Barometer-2021-Albania-4-ENG.pdf>





## - Komisionit Evropian dhe vendeve anëtare të BE-së:

- Duke u bazuar në opinionin e Komisionit Evropian në Mars 2020,<sup>3</sup> duhet të merren masa dhe ritme të përshpejtuara, për të inicuar sa më shpejt të jetë e mundur procesin formal të negociatave për aderimin e Shqipërisë në BE;
- Të ketë monitorim rigoroz si nga Komisioni ashtu edhe nga vendet anëtare mbi harmonizimin dhe **implementimin** e plotë të *acquis*;<sup>4</sup>
- Duke u bazuar në metodologjinë e re, si dhe në eksperiencën e vendeve që tashmë kanë nisur procesin, të merren për bazë mendimet dhe ekspertizat e të gjithë faktorëve dhe aktorëve shoqëror shqiptar mbi procesin dhe zbatueshmërinë e rekomandimeve të Komisionit në hartimin e raporteve vlerësues, me fokus të veçantë Grupimin e Parë të Kapitujve (Cluster 1).

## - Institucioneve publike, pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ:

- Të intensifikohen përpjekjet, si dhe të mos ndërpriten masat dhe praktikrat reformuese, me qëllim përmbushjen e të gjitha rekomandimeve të adresuara nga ana e Komisionit Evropian, të dokumentuara në Raportet vjetore, si dhe në çdo mekanizëm tjetër ku Bashkimi Evropian dhe Shqipëria janë pjesë apo bashkëpunojnë;
- Të fokusojnë prioritetet e tyre në organizimin e brendshëm institucional, ku përfshihen burimet njerëzore dhe financiare, në fazën para dhe gjatë negociatave për anëtarësim duke u udhëhequr nga metodologjia e re e zgjerimit;
- Të draftohen planet e veprimit, të udhëhequra në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë mbi shtetin e së drejtës dhe të gjithë çështjet që mbulohen në Grupimin e Parë të Kapitujve (Cluster 1) si fushat kyçe për një avancim sa më të shpejtë dhe cilësor të të gjithë procesit të integritimit në tërësi;
- Nënshtrimin e procesit të integritimit evropian si një tematikë e debatit dhe konsultimit publik, me synim përfshirjen dhe grumbullimin e mendimeve dhe opinioneve të adresuara, dhe të mos shihet si një çështje vetëm shtetërore, por të analizohet në nivel kombëtar me përfshirjen e të gjithë grupeve të interesit, shoqërisë civile, botës akademike, medias dhe individëve që duan të kontribuojnë në avancimin e këtij procesi;
- Të synohet në mënyrë të qartë dhe të pazëvendësueshme anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Çdo nismë tjetër rajonale apo evropiane të shihet si kontribuese dhe jo alternativë apo dualizim i procesit të integritimit.

<sup>3</sup> Komunikimi i Komisionit Evropian dhe Këshillit Evropian në Mars 2020 për dhënien e rekomandimit mbi hapjen e negociatave për anëtarësim për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

<sup>4</sup> (*acquis*) përfshin të gjithë legjislacionin e BE-së të miratuar nga institucionet e saj. Ai ndahet në tre tipe: legjislacion parësor; legjislacion dytësor; dhe jurisprudenca. Së bashku, ato formojnë legjislacionin e BE-së, i cili duhet të adoptohet nga vendet candidate (duke ndryshuar legjislacionin e tyre përkatës) para se të bëhen anëtare të BE-së.





## - Sektorit të Shoqërisë civile në tërësi, grupeve të interesit, medias dhe qytetarëve:

- Të përfshihen proaktivisht nëpërmjet pjesëmarrjes në sesionet dhe tryezat e diskutimit, me qëllim dhënien e kontributit të mundshëm në avancimin e procesit të integritimit sipas fushës së tyre të interesit dhe ekspertizës.
- Gjithashtu, përfaqësuesit e sektorit të shoqërisë civile, me synim adresimin e opinionëve dhe sugjerimeve cilësore duhet të analizojnë dhe të shfrytëzojnë çdo hapësirë ligjore apo teknike në monitorimin e ecurisë së këtij procesi të rëndësishëm për vendin tonë.

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes  
Komiteti Shqiptar i Helsinkit  
Instituti i Studimeve Politike  
Insitituti Shqiptar i Shkencës



*Kjo Deklaratë është realizuar nga organizatat partnere të Projektit "Përmirësimi i Debatit të Politikave dhe Llogaridhënies në Përbushjen e Grupit të Parë të Kapitujve Negociues (Cluster 1), përmes Krijimit të Platformës së Negociatave BE-Shqipëri për Cluster 1 (C1-EU-NPA)", mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë*

*Çdo pikëpamje ose opinion i paraqitur në këtë Deklaratë është vetëm i organizatave partnere dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht ato të donatorit.*

